

Ky raportim u ndikua në masë të madhe nga shpërthimi i COVID-19. Kjo krizë globale shëndetësore ka paraqitur një sfidë për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve në kuadër të Programit. Megjithatë, në pajtim me masat e ndërmarra në Zvicër dhe në Maqedoninë e Veriut, DCAF vazhdoi punën por duhej t'i përshtatej situatës. Për rrjedhojë, aktivitetet janë anuluar, shtyrë apo zëvendësuar. Në vend të takimeve me prani fizike (ball për ballë), janë zgjedhur platformat virtuale. Për më tepër, shmangia e udhëtimeve në këtë periudhë ishte një mundësi për ekipin që të investojë më shumë në hulumtime dhe analiza ligjore. Ky buletin do të tregojë në mënyrë të detajuar se çfarë llojë aktivitete mund të realizoheshin për shkak apo përkundër kufizimeve të lëvizjeve në ndjekjen e qëllimit të programit. Në 10 qershor, në bashkëpunim me Ambasadën Suedeze në Shkup, DCAF bashkë – organizoi Takimin e 9-të Grupit të Donatorëve Drejtues të Programit për Reforma në Sektorin e Kundërzbulimit – duke përdorur platformën online të koduar E2E. Grupi i donatorëve përbëhet nga ambasadorët rezident dhe stafi që përfaqëson Kroacinë, Delegacionin e BE-së, Gjermaninë, Hollandën, Suedinë, Zvicrën, MB dhe SHBA. Pikët e agjendës të kërkuara nga organizatorët suedez kanë përfshirë: Përgjigjet (reagimet) ndaj COVID – 19; përditësimin e aktiviteteve; skenaret e lidhura me zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe koncept propozimin e dorëzuar së fundi nga DCAF jë ndërhyrje në vazhdimësi të programit (3 + 2 vite).

## Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2017-2020)

### BULETINI INFORMATIV N°6 PRILL – QERSHOR 2020

#### Programi për Reforma në Sektorin Zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

*Nëntor, 2017- Dhjetor, 2020*

Nga nëntori 2017, Programi ka për qëllim të përforcojë stabilitetin, sundimin e ligjit, dhe sigurinë për Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes përmirësimit të llogaridhënies dhe udhëheqjes së sektorit të zbulimit.

Programi është strukturuar në katër segmente:

**SEGMENTI I:** Reforma në shërbimin e zbulimit – forcimi i mekanizmave të brendshëm për mbrojtje dhe kontroll

**SEGMENTI II:** Zhvillim i mbikëqyrjes parlamentare dhe të pavarur

**SEGMENTI III:** Zhvillim i standardeve gjyqësore dhe atyre të prokurorisë dhe kapacitetit për autorizim dhe rishikim i Metodave Speciale Hetimore (MSH)

**SEGMENTI IV:** Fondi për reagim të shpejtë – për t'i ofruar përfituesit këshilla dhe ndihmë ad-hoc, ka të bëjë me, por nuk lidhet drejtpërsëdrejti me Segmentin I, II ose III

**Donatorët:** Mbretëria e Bashkuar (FCO-CSSF), Holanda (Ministria e Punëve të Jashtme), Suedia (SIDA) dhe Zvicra (SDC)

**Partnerët:**

- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Shërbimet e sigurisë dhe zbulimit
- Drejtoria për Mbrojtje të Të Dhënave Personale;
- Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara;
- Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë;
- Zyra e Prokurorit Publik kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit
- Institucione të tjera të gjykatave dhe gjyqësorit ;
- Avokati i Popullit;
- OJQ.

## SEGMENTI I

ASi vazhdimësi e procesit të shumë palëve të interesit, mbi hartimin e **Procedurave Standarde Operative për Mbikqyrje dhe Kontroll të Shërbimeve të Kundërzbulimit dhe të Sigurisë, është organizuar një uebinar trajnimi** në 30 qershor të vitit 2020. Qasja e uebinarit elektronik (online) është pjesë e reagimit të DCAF ndaj COVID - 19, për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga shërbimet e kundërzbulimit dhe sigurisë që janë përgjegjës për bashkëpunimin ndër-institucional dhe homologët e tyre nga institucionet me funksion mbikqyrës apo kontrollues që janë përgjegjës në këtë sektor.

Uebinari ka përmbledhur njohuri dhe informacione nga punëtoritë e mëparshme praktike të mbajtura në Shkup (10 dhjetor 2019) dhe Veles (19-20 shkurt 2020). Pjesëmarrësit kanë diskutuar specifikat e kërkesave të mbikqyrjes dhe kontrollit gjatë COVID - 19 dhe gjatë gjendjes të jashtëzakonshme dhe diskutuan si të vazhdojnë më tutje për hartimin e **Procedurave Standarde Operative (PSO)** për kryerjen e mbikqyrjes dhe kontrollit mbi shërbimet e sigurisë dhe kundërzbulimit. Uebinari, ku janë përfaqësuar 15 institucione, është lehtësuar nga DCAF me një kontribut të veçantë nga prof. Nikola Dujovski, Dekan i Fakultetit të Sigurisë në Shkup. Intervenimi i tij është fokusuar mbi rëndësinë dhe domethënien e kontrollit dhe mbikqyrjes përmes një perspektive të integritimit në BE dhe rolin e institucioneve relevante në sigurimin e llogaridhënies në punën e shërbimeve të sigurisë dhe kundërzbulimit. Procesi me shumë palë të interesuara për zhvillimin e mbikqyrjes dhe kontrollit të PSO do të

vazhdojë dhe do të përfshijë grupe më të vogla dhe më të fokusuar të hartimit.

Në maj, DCAF inicoi hartimin e një dokumenti të analizës mbi zbrazëtitrat ligjore dhe zbatimet praktike të legjislacionit të ri të reformës në sektorin e sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Ekspertët, dy profesorët e respektuar nga Akademia Ushtarake dhe Fakulteti i Sigurisë, identifikuan “dobësitë” ose papërcaktimin e legjislacionit dhe dispozitave, konfliktin me dispozita tjera në ligje tjera, përplasjet e mundshme. Studimi thekson se reforma e legjislacionit ekzistues është bërë duke përdorur sistemet ligjore të shteteve tjera pa i përshtatur ata me kontekstin maqedonas dhe kapacitetet ekzistuese të institucioneve të sektorit të sigurisë. Ligjet e reja ofrojnë disa zgjidhje cilësore normative por zbatimi i tyre praktik mbetet i diskutueshëm.

DCAF Geneva Centre for Security Sector Governance 20<sup>TH</sup> ANNIVERSARY

**Punëtoritë e tretë praktike  
Uebinari i parë përgatitës**

30.06.2020  
11:00-12:30

**„PROCEDURAT E PËRBASHKËTA OPERATIVE  
PËR KRYERJEN E MBIKQYRJES DHE KONTROLLIT  
MBI SHËRBIMET E SIGURISË DHE KUNDËRZBULIMIT“**

**Prof. Nikola Dujovski**  
Dekan  
Fakulteti i Sigurisë - Shkup  
UKLO Manastir

**Andrej Rupnik**  
Drejtor  
Qendra e Gjenerës për qeverisjen  
e sektorit të sigurisë - DCAF

## SEGMENTI II

I Fillimisht të hartuara nga DCAF së bashku me ekspertët e mbikqyrjes të jashtme dhe deputetët, dhe të botuara në maj të vitit 2018, **Udhëzimet mbi Mbikqyrjen Parlamentare të Kundërzbulimit** janë një produkt i dobishëm i njohurive për komitetet e mbikqyrjes parlamentare. Sidoqoftë, për shkak të një kornize të re legjislative dhe formimit të institucioneve të reja që nga botimi i saj, ekzistonte nevoja për rishikimin e Udhëzimeve. Rishikimi është ndërmarë në bashkëpunim të ngushtë me palët e përfshira lokale përmes disa takimeve të rishikimit të ndryshimit duke përfshirë stafin parlamentar dhe ekspertët lokal mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar. Qëllimi, përmes këtij procesi ishte që të rritet efektiviteti i aktorëve parlamentar kur bëhet fjalë për procesin e mbikqyrjes të kundërzbulimit. Për më tepër, ky vëllim respektivisht botimi i dytë është rishikuar dhe ndryshuar nga perspektiva gjinore. Është vlerësuar se versioni përfundimtar dhe përkthimet do të botohen në korrik apo në fillim të gushtit të vitit 2020.

Në fillim të vitit 2020, DCAF inicioi një bashkëpunim të ngushtë me Institucionin Nacional Demokratik (NDI) në mënyrë që të mbështesin bashkarisht Parlamentin maqedonas në **hartimin e përshkrimeve të reja të punës për stafin parlamentar**, duke ndihmuar që të përforcohet kapaciteti i stafit në mbështetjen e komiteteve të sigurisë dhe të kundërzbulimit. Optimizimi, përmes koordinimit dhe gjithëpërfshirjes të programit, për aktivitetet që kanë qëllime të përbashkëta, është i nevojshëm për të shmangur përplasjen joproductive. Në koordinim me NDI dhe partnerin e tij lokal të OSHC - Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve, është rënë dakord se DCAF do të përfshihet në procesin e hartimit të përshkrimeve të reja të punës për stafin parlamentar në njësinë e punës duke mbështetur tre komitetet e mbikqyrjes të sigurisë dhe kundërzbulimit. Kjo punë është për NDI një nga shumë fusha thelbësore të reformës për përmirësimin dhe optimizimin e punës dhe sistematizimit të Parlamentit.

### Financimi i programit dhe mekanizmat e drejtimit

Për këtë Program u zgjodh mekanizmi për financim me grumbullim/bashkim të mjeteve. Që nga dhjetori 2018, për këtë Program kontribuojnë financiarisht katër shtete donatore: Holanda (CHF 546'449), Suedia (CHF 520'000), Zvicra (CHF 500'000), dhe Mbretëria e Bashkuar (CHF 283'917), që së bashku me kontributin e buxhetit kryesor të vetë DCAF-it (CHF 315'000) janë gjithsej CHF 2'165'366. Gjithashtu, kuvendi i Maqedonisë së Veriut ofron mbështetje me kontribut duke i siguruar Programit hapësira pune, salla konferencash dhe mjete teknike pa pagesë.

Nga perspektiva e donatorëve, ky Program udhëhiqet nga Grupi Drejtues i Donatorëve i përbërë nga ambasadorë dhe staf të partnerëve që kontribuojnë financiarisht dhe politikisht (Kroacia, Delegacioni i BE-së, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara), që në mënyrë aktive angazhohen lidhur me Programin duke ofruar mbështetje dhe udhëheqje politike dhe strategjike. Takimet e Grupit Drejtues të Donatorëve mbahen një herë në tre muaj dhe organizohen nga ambasadat e donatorëve me rrotacion.

Aktivitetet e Programit nën Segmentin II udhëhiqen nga Grupi Drejtues i Parlamentit i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Grupi Drejtues i Parlamentit gjithashtu përfshin tre kryetarë të komisioneve përkatëse dhe përfaqësues të DCAF. Takimet e Grupit Drejtues të Parlamentit mbahen dy herë në vit në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.



## SEGMENTI III

Që nga paraqitja e suksesshme, fillestare dhe rajonale e **Doracakut për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve** në fund të vitit 2019 dhe në fillim të 2020, DCAF ka angazhuar tre ekspertë për të hartuar një **planprogram të trajnimit**. Tre ekspertët lokal janë duke punuar në hartimin e mjeteve të trajnimit që janë dizajnuar për të siguruar zhvillimin e kapaciteteve lokale të trajnimit mbi autorizimin gjyqësorë dhe rishikimin e ndjekjes të komunikimeve. Duke u bazuar në doracakët e trajnimit, të përfunduara në qershor të vitit 2020, ata do të përgatisin dhe lehtësojnë **Kurset e trajnimit të trajnerëve (TT)** në gusht apo shtator të vitit 2020 për reth 15 praktikantë (gjykatës dhe prokurorë). Kjo do u mundësojë atyre për të ofruar trajnimin mbi autorizimin gjyqësorë të ndjekjes të komunikimeve, si për trajnimet e vazhdueshme profesionale ashtu edhe për nivelin hyrës në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë. Aktivitetet janë organizuar në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së.

## SEGMENTI IV

Gjatë shpërthimit të COVID - 19, DCAF zhvilloi një ekspertizë tematike dhe prodhoi një **dokument me analiza në lidhje me respektimin e mbrojtjes të të dhënave personale dhe mbrotjen e disa të drejtave themelore të njeriut në kushte të një parlamenti të shkarkuar dhe një gjendjeje të jashtëzakonshme të deklaruar në Maqedoninë e Veriut**. Një ekspert i lartë lokal mbi mbrojtjen e të dhënave personale ka identifikuar implikimet mbi masat e sektorit të sigurisë dhe shëndetësisë në lidhje me shpërthimin e COVID - 19 në Maqedoninë e Veriut nga perspektiva e mbrojtjes të të dhënave personale. Kjo analizë është përfunduar në qershor të vitit 2020, dhe së shpejti do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të DCAF në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

EUROTHINK, një partner dhe organizatë e shoqërisë civile e bazuar në Shkup, e angazhuar nga DCAF, ka përfunduar artikullin e parë të shkurtë: **Paratë publike të shpenzuara në mënyrë të fshehtë: Kush i kontrollon financat e shërbimeve të sigurisë dhe kundërzbulimit? që do të botohet në faqen e tyre të internetit në gusht të vitit 2020**. Ekipi projektues i EUROTHINK punon gjithashtu mbi një **Dokument të politikave mbi mbikqyrjen e kundërzbulimit** me rekomandime të politikave që synon përmirësimin e legjislacionit dhe praktikës. Pasi të përfundohet, ekipi projektues i EUROTHINK do ta botojë atë në faqen e tyre të internetit gjatë shtatorit - tetorit të vitit 2020. Për më tepër, nëse situata dhe kushtet lejojnë, EUROTHINK do të organizojë një konferencë për shtyp për përfundimet e tyre. Përndryshe, EUROTHINK dhe ekipi projektues do ta promovojnë atë përmes platformës elektronike (online).





**Që nga marsi i vitit 2020**, dhe si një pjesë e integruar e bashkëpunimit me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, DCAF ka mbështetur Drejtorinë në përpjekjet e saj për të hartuar **aktet nënligjore për sigurinë administrative, fizike, industriale, të informacionit dhe të përdoruesit, të informacioneve të klasifikuara**, që rrjedhin nga Ligji i miratuar së fundi – Ligji mbi Informacionin e Klasifikuar. Profesorët e respektuar nga Fakulteti i Filozofisë, Instituti për Siguri, Mbrojtje dhe Paqe nga Fakulteti i Drejtësisë në Shkup, janë angazhuar si ekspertë nga DCAF për të ofruar kontributin e tyre të vlefshëm. Aktet nënligjore përfundimtare janë në procesin e shqyrtimit dhe miratimit nga Qeveria.

Në fund të qershorit, ekipi projektues i DCAF, në bashkëpunim me ekspertin e brendshëm gjinor të DCAF, kanë botuar një **Dokument informativ mbi gjininë në mbikqyrjen e kundërzbulimit dhe atë parlamentare**. Në këtë dokument diskutohet rëndësia e përfshirjes të perspektivës gjinore në punën dhe funksionimin e institucioneve të sektorit të kundërzbulimit dhe përmes aktiviteteve të mbikqyrjes. Për më tepër, ekipi ka parë gjendjen e pandryshuar (status quo) në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ka ofruar disa rekomandime për përmirësim. Dokumenti do të shërbejë si një nxitës për ngjarjen e ardhshme mbi Gjininë në kundërzbulim, që do të mbahet në shtator të vitit 2020.





## **NGJARJE TË ARDHSHME**

Për shkak të pandemisë COVID-19, aktivitetet e planifikuara ose u anuluan, u shtynë apo u realizuan me mjete elektronike (online). Sidoqoftë, duke patur parasysh përmirësimin e situatës në Europën qendrore dhe për shkak të lehtësimit të masave mbrojtëse të ndërmarra nga shtetet, stafi i DCAF gradualisht ka filluar që të rikthehet në zyrat e tyre. Sidoqoftë, shëndeti i stafit të DCAF si dhe i të gjithë palëve të interesit gëzon prioritetin më të madh dhe rrjedhimisht, aktivitetet e realizuara gjithmonë do të përshtaten me situatën aktuale, masat do të respektohen gjithmonë, dhe do të kryhet vazhdimisht vlerësimi i rrezikut.

### **KORRIK**

- Hartimi i Procedurave Standarde Operative për Mbikqyrje dhe Kontroll të Shërbimeve të Kundërzbulimit dhe Sigurisë
- Botimi i Udhëzimeve të rishikuara mbi mbikqyrjen parlamentare të kundërzbulimit
- Hartimi i mjetit transformativ të trajnimit duke u bazuar në mjetin mbi gjininë dhe kundërzbulim

### **GUSHT**

- E-takimi përfundimtar për të përfunduar dhe miratuar botimin e Procedurave Standarde Operative për mbikqyrje dhe kontroll të kundërzbulimit dhe shërbimeve të sigurisë
- Përgatitja e materialeve të trajnimit dhe produkteve

tjera të njohurisë për deputetët e rinj dhe stafin, si dhe shpërnarja

- 3 ditë (dy netë) Trajnim i trajnerëve (TT) mbi Doracakun për planprogramin e trajnimit që do të mbahet jashtë Shkupit

### **SHTATOR**

- Përforcimi i kapaciteteve të personelit të institucioneve të kundërzbulimit dhe stafit parlamentar mbi legjislacionin për mbikqyrjen e inteligjencës
- Lehtësimi i hapësirave të mbrojtura dhe hapësira të mbrojtura të punës
- Mbikqyrja e aktiviteteve të trajnimit për deputetët e rinj, KMQ dhe OSHC
- Promovimi i Udhëzimeve mbi Mbikqyrjen parlamentare të kundërzbulimit
- 2 - ditë trajnim jashtë Shkupit për praktikantët ligjor në Maqedoninë e Veriut, të lehtësuara nga trajnerët e TT.